



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:174556  
Datë: 19.04.2024  
Numri i dokumentit: 05593055

**PA1.nr.1279/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.S nga Podujeva, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit N.S, av. H.P dhe ankesës së përfaqësuesit të dëmtuarit R.B, av. N.R, të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.63/21 të dt.01.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 27.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen** si të pabazuara ankesa mbrojtësit të të akuzuarit N.S, av. H.P dhe ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarit R.B, av. N.R, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.63/21 të dt.01.08.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, me aktgjykimin, P.nr.63/21 të dt.01.08.2023, të akuzuarin N.S e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Kosovës dhe i ka shqiptuar Dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim do ta vuaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë. Konform nenit 79 të KPRK-së të akuzuarit në dënimin e shqiptuar me burgim i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data

09.12.2020 deri me datë 09.03.202, po ashtu gjykata i ka shqiptuar Masën e Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri- në Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë, të cilës masë do ti nënshtrohet pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, e në rast të mospërfilljes së kësaj mase të trajtohet në Klinikën e Psikiatrisë në Prishtinë. Masa e Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri nuk mund të zgjasë më tepër se 3 vite. Pas kalimit të këtij afati , nëse gjykata nuk ka marrë ndonjë vendim tjetër atëherë kjo masë pushon së ekzistuari në mënyrë automatike. Detyrohet i akuzuari që t'i nënshtrohet trajtimit psikiatrik në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë, në të kundërtën po që se nuk i nënshtrohet këtij trajtimi psikiatrik në liri apo ndërpret trajtimin në mënyrë arbitrare, gjykata ndaj të akuzuarit do të caktoj masën e trajtimit të caktuar të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në klinikën psikiatrike. Informohet Qendra e Shëndetit Mendor në Podujevë, se të akuzuarit i është caktuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri dhe i njëjti duhet të paraqitet për trajtim të caktuar sipas udhëzimeve apo arbitrarisht e ndërprejë trajtimin. Detyrohet Qendra e Shëndetit Mendor në Podujevë, që pas fillimit të trajtimit të informoj gjykatën çdo 6 (gjashtë) muaj duke i paraqitur raportin me shkrim për mbarëvajtjen e këtij trajtimi të detyrueshëm psikiatrik ndaj të akuzuarit, duke konstatuar se a është apo nuk është i nevojshëm trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri ndaj të njëjtit. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 170 (njëqind e shtatëdhjetë) euro, në emër të ekspertizës mjekoligjore shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në emër të ekspertizave të komunikacionit rrugor shumën prej  $4 \times 40.88 = 163,52$  Euro (njëqind e gjashtëdhjetë e tre euro e pesëdhjetë e dy cent) , në emër të ekspertizës së Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës shumën prej 450 (katërqind e pesëdhjetë) Euro, në emër të super ekspertizës së komunikacionit rrugor shumën 900 (nëntëqind) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar, R.B, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko –civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit N.S, av, H.P, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale , për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovoj si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të mbrojturit të tij N.S të lirohet nga akuza ose ta anulon aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen t'ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit R.B, av. N.R për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe se të akuzuarit ti shqiptoj dënim shumë më të lartë në raport me pasojen e shkaktuar.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1313/23 të datës 12.10.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palëve të të dëmtuarve A dhe R.B, av.N.R, e ushtruar kundër aktgjykimit të ankimuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal, në atë mënyrë që të akuzuarit N.S

t'i shqiptohet dënim më i lartë në raport me pasojën e shkaktuar. Të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit N.S, av. H.P, për shkak të të gjitha bazave ankimore.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën prezantoi i akuzuari N.S, mbrojtësi i të akuzuarit, av. H.P dhe i dëmtuari, A.B. Prokuroria e Apelit, si dhe palët tjera, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë. I dëmtuari, A.B deklaroi se qëndron pranë ankesës së ushtruar dhe propozimit si në ankesë, i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike. Mbrojtësi i të akuzuarit, av. H.P deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar dhe propozimit si në ankesë, duke shtuar se aktgjykimi i shkallës së parë ka kundërthënie dhe janë bërë shkelje, pasi që kanë kundërshtuar dhe nuk janë pajtuar të lexohen deklaratat e dëshmitarëve SH.S dhe N.Ç në shqyrtim gjyqësor, duke qenë se ata kanë qenë dëshmitarë okular dhe pjesëmarrës drejtpërdrejtë në aksident dhe kanë kërkuar që ata të vijnë në seancë dhe të dëgjohen në mënyrë të drejtpërdrejtë që të mundësohet ushtrimi i drejtpërdrejt i pyetjeve nga ana e të akuzuarit dhe mbrojtësit, kështu konsideron se gjykata pa pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ka marr aktvendim në procesverbal të seancës së mbajtur 18.07.2023 , faqe 2, me të cilën e ka refuzuar propozimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij që të thirren dhe të dëgjohen dëshmitarët e lartpërmendur duke ua mohuar të drejtën palëve që drejtpërdrejt të parashtrojnë pyetje dëshmitarëve lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare, andaj konsideron se ka tejkalim akuze, tutje deklaroi se i mbrojturi i tij ka qenë me traktor me shpejtësi prej 20 km/h në shiritin e tij të lejuar në anën e djathtë të rrugës, drutë në ram mbrapa kanë qenë të shënjuara me trekëndësh tregues dhe me llastik, në mënyrë të drejtë dhe të rregullt. Nga deklarata e ekspertit të komunikacionit M.B , anëtarë i grupit të ekspertëve të fakultetit teknik në Prishtinë rezulton se në rastin e të akuzuarit N kemi të bëjmë qartë vetëm me kundërvajtje e jo me vepër penale për të cilën akuzohet. Po ashtu cekë se përkundër shkeljeve të pa kontestueshme të vozitësit të veturës (B), (C) dhe (D), prokurorja për çudi ka vënë nën akuzë vetëm vozitësin e traktorit (A) N.S dhe ky vendim i prokurores është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse dhe është kërkuar zgjerimi i aktakuzës edhe ndaj pjesëmarrësve të tjerë në aksident. I akuzuari ka qenë duke ngarë traktorin me shpejtësi adekuate, me sjellje që i lejon shoferit që ta kontrollon automjetin në kushtet ekzistuese të komunikacionit, në pajtim me rregullat e komunikacionit, po ashtu sa i përket përgjegjësisë penale, theksoi se i mbrojturi i tij ka përgjegjësi penale të kufizuar esencialisht, duke propozuar që i njëjti të lirohet nga akuza. I akuzuari, N.S deklaroi se mbetet pranë ankesës së parashtruar dhe propozimit si në ankesë dhe përkrah avokatin e tij mbrojtës dhe deklaroi se nuk ndihet fajtor sepse ka qenë në shpejtësi të ulët të paraparë me rregullat e komunikacionit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**-Ankesat nuk janë të bazuara.**

Mbrojtësi i të akuzuarit N.S, av, H.P e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale , për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal. Lidhur me pretendimet se ka shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale konsideron se në aktgjykimin e ankimuar nuk janë paraqitur arsye të qarta për çdo pikë të aktgjykimit e kjo përbën shkelje për çka aktgjykimi i ankimuar detyrimisht duhet të priset. Gjykata nuk ka paraqitur në aktgjykim se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i ka konsideruar të vërtetuara po të pavërtetuara , nuk ka paraqitur arsyet e mos miratimit të propozimeve konkrete të paraqitura nga palët gjatë zhvillimit të procedurës. Po ashtu gjykata e shkallës së parë pa pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, ka marrë aktvendim në procesverbal të seancës së mbajtur me 18.07.2023, faqe 2, me të cilin e ka refuzuar propozimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij që të thirren dhe të dëgjohen dëshmitarët SH.S dhe N.Ç, duke ua mohuar të drejtën që drejtpërdrejt të parashtrojnë pyetje lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare, ngase i akuzuari dhe mbrojtësi i tij dëshmitarët e lartpërmendur i kanë konsideruar si dëshmitarë kyç në vërtetimin e drejtë dhe të plotë të kësaj gjendje faktike, për shkak se ata janë dëshmitarë okular. Gjykata e shkallës së parë e ka tejkalluar aktakuzën pasi që në seancën e mbajtur me 04.10.2022 prokurori i shtetit ka ndryshuar aktakuzën ashtu që ka kërkuar që të akuzuarit t'i shqiptohet masa trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri. Në kundërshtim me ndryshimin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata e ka gjykuar të akuzuarin me 1 (një) vit burg, dhe kjo paraqet shkelje absolute të dispozitave të procedurës penale sepse në këtë rast nuk ekziston identiteti objektiv dhe subjektiv ndërmjet aktakuzës dhe aktgjykimit të ankimuar. Lidhur me pretendimet se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, mbrojtësi i të akuzuarit konsideron se policia ka bërë raportin e vendit të ngjarjes dhe i akuzuari N.S dhe dëshmitari A kanë pohuar se nuk dinë arsyet pse në raportin e policisë nuk është shënuar se aty ka qenë edhe trekëndëshi tregues dhe llastiku, me të cilat kanë qenë të shenjzuara drutë nga pjesa e pasme e ramit, ndoshta drutë e rrëzuara e kanë zënë përfundi, ndoshta ato kanë mbetur diku në mes të druve s'i ka parë policia, apo i ka par por s' dihet për ç'arsye nuk janë shënuar në raport të policisë ( pra, jo gabimisht ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë se vetura B u ka ra druve mbrapa, kjo edhe fizikisht ka qenë e pamundshme të realizohet sepse drutë kanë qenë lartë në ramë, e vetura e ulët s'ka pasur mundësi teknike që t'i mbërrijë drutë.) Në një gjendje të tillë të vërtetuar në mënyrë të plot dhe të drejtë del se është i drejtë deklarimi i të akuzuarit N.S se nuk ndihet fajtor dhe nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Deklarata e tij ka mbështetje të fuqishme në provat e administruara në shqyrtim gjyqësorë nga të cilat katërçipërisht u vërtetua se i akuzuari N në çastin e aksidentit ka qenë duke vozitur traktorin në shiritin e tij të lejuar në anën e djathtë të rrugës me shpejtësi të lejuar rreth 20km/h , drutë në ram mbrapa kanë qenë të shënuara me trekëndësh tregues dhe me llastikë, në mënyrë të drejtë dhe të rregullte. Mungesa e dritës së kuqe në ram të traktori nuk përmban element të veprës penale Rrezikim të trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe par 1 të KPRK-së, mungesa e dritës së kuqe në ram të traktorit paraqet kundërvajtje dhe kryerësi i kundërvajtjes gjobitet me gjobë 20 euro. Përcaktimi me dispozita ligjore i mungesës së dritave si kundërvajtje, përjashton çdo mundësi që në veprimet e të mbrojturit të tij të sajohen elementet e veprës penale për të cilën ai akuzohet. Eksperti i komunikacionit M.B, anëtarë i grupit të ekspertëve të Fakultetit Teknik në Prishtinë, rezulton qartë se në rastin e të akuzuarit N.S kemi të bëjmë me një kundërvajtje e jo me vepër penale për të cilën akuzohet, ai ka sqaruar

se: “ Lëshimet e drejtuesit të traktorit kanë qenë se ka drejtuar mjetin e punës pa sinjalizim përkatës në kohën kur dukshmëria ka qenë e kufizuar, ky ka qenë lëshimi i vetëm , pra mungesa e dritës së kuqe në ram nuk ka shkaktuar rrezikun e përgjithshëm në rastin konkret. Rreziku i përgjithshëm është sajuar në veprimet e pjesëmarrësve në komunikacion në vendin e shkakimit të aksidentit ka qenë në 40km/h dhe ky fakt vendimtar u vërtetua në mënyrë të pakontestueshme nga të gjitha provat e administruara. Sipas ekspertit Y.K vozitësi i veturës Golf 19 (B), A(A) B ka vozitur me shpejtësi 83,16km/h në të njëjtën kah me traktorin (A) , ndërsa sipas ekspertizës së grupit të ekspertëve 83,58km/h, që do të thotë më shumë se dyfishi i shpejtësia së lejuar krahasuar me kufizimin e shpejtësisë në vendin e aksidentit, për shkak se A ka qenë shofer i ri dhe pa përvojë, vetëm 3 javë më parë e kishte dhënë provimin për shofer të kategorisë B, nuk ka mundur të kontrollojë veturën në kushtet ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht duke pasur parasysh pamjen, kushtet e dukshmërisë, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit dhe e ka shkaktuar aksidentin. A ka shkaktuar rrezikun e përgjithshëm sepse e ka drejtuar veturën në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 të Ligjit mbi sigurimin e komunikacionit rrugor të Republikës së Kosovës. Në rastin konkret rruga ka qenë e lagur sepse kishte filluar të bjerë shi , dukshmëria e zvogëluar sepse kishte filluar të errësohet dhe dendësia e madhe e komunikacionit ,A ka shkaktuar rrezikun e përgjithshëm sepse ka shkelur dispozitat e nenit 53,1 të Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor të Republikës së Kosovës, aksidentin e ka shkaktuar A sepse në kundërshtim me dispozitat e nenit 68 LSKRRRK e ka filluar tejkalimin pa qenë i siguruar se ekziston fushëpamja dhe hapësira e mjaftueshme që ta bëjë tejkalimin pa i rrezikuar pjesëmarrësit tjerë. Të gjitha këto janë vërtetuar ekzaktë me prova valide të administruara në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu, N.Ç , vozitësi i veturës VW golf 1J(C) gjithashtu e ka shkaktuar rrezikun e përgjithshëm sepse ka shkelur dispozitat e nenit 53,1 të Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor të Republikës së Kosovës dhe ka vozitur veturën VW Golf 1J (C) në kahe të kundërt me traktorin (A) nga Podujeva në drejtim të fshati ./... me shpejtësi 72.19 km/h sipas ekspertit Y.K dhe 72,54km/h sipas grupit të ekspertëve që do të thotë rreth dyfish më shpejtë krahasuar me kufizimin e shpejtësisë në vendin e aksidentit. Në vendin e aksidentit nuk janë gjetur shenja të frenimit që do të thotë se nuk ka bërë përpjekje për shmangien e aksidentit , por e ka goditur veturën (B) në derë të parë. Edhe vozitësi i veturës Golf 1J (D) SH.S i ka kontribuar shkakimit të rrezikut të përgjithshëm për arsye se ka vozitur me shpejtësi 60,10 sipas ekspertit B.S , dhe 55,60km/h sipas ekspertizës së grupit të ekspertëve, që do të thotë se rreth një herë e gjysmë më shpejtë se sa shpejtësia e lejuar në vendin e aksidentit. Nuk ka mbajtur distancën e detyrueshme të përcaktuar me dispozita ligjore me veturën (C). Përkundër shkeljeve të këtilla të pakontestueshme të vozitësit të veturës (B), (C) dhe (D), prokurorja e rastit N.S, për çudi , ka vënë nën aktakuzë vetëm vozitësin e traktorit ( A), N.S. Ky veprim i prokurores është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse dhe është kërkuar zgjerimi i aktakuzës edhe ndaj pjesëmarrjeve të tjerë në aksident. N ka qenë duke ngarë traktorin me shpejtësi adekuate, me sjellje që i lejon shoferit që ta kontrollojë automjetin me shpejtësi ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht duke pasur parasysh fushëpamjen , kushtet e dukshmërisë , kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit, pran në tërësi në pajtim me rregullat e komunikacionit. Aksidentit ka mundur të evitohet dhe kjo u vërtetua gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të pakontestueshme. Grupi i ekspertëve Prof. Dr. R.D, Dr.sc. M.B dhe Msc. G.K , në faqen 16-17 të ekspertizës së tyre e kanë shtjelluar mundësin e evitimit të aksidentit dhe kanë ardhur në përfundim se aksidenti ka mund të evitohet sikur pjesëmarrësit në aksident ta kishin respektuar

kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes dhe të kishin frenuar vrullshëm para pengesës së shfaqur në rrugë. Po të njëjtin mendim dhe konstatim e ka dhënë edhe eksperti Y.K , në faqen 14 pasuesi 2 i ekspertizës së tij, ku thuhet :” Deri tek ky aksident nuk do të vinte sikur shoferi i veturës (B) të lëvizte me shpejtësi të kufizuar 40km/h, me të cilin rast me frenim të vrullshëm do të ndalte veturën në distancën prej 20,5m, pra 19,5 para se të ndeshet me traktorin, ndërsa për distancën që ka pasur në dispozicion kur ka vërejtur rrezikun (36m) do ta ndalte automjetin prapa rimorkios me ngadalësim normal prej 3,0 m/s<sup>2</sup> pa pasur nevojë të frenojë vrullshëm. Ekspertët e sipër përmendur pranë këtyre mendimeve dhe konstatimeve kanë qëndruar edhe gjatë sqarimeve në shqyrtimet gjyqësore, prandaj mund të konkludohet se rrezikun e përgjithshëm e ka shkaktuar vozitësi i veturës (B), për shkak të mos respektimit të rregullave ligjore të komunikacionit, mungesës së aftësisë së nevojshme profesionale dhe të përvojës , e jo shoferi i traktorit (A) tani i akuzuari, edhe në kushtet që nuk ka pasur dritën e kuqe të ndezur në ram mbrapa. Po ashtu , shton se i akuzuari sipas ekspertizës së Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të datës 26.07.2022 është diagnozifikuar me diagnozë Retardim mendor me shifër F-70 (ICD-10 si dhe çrregullim i stresit pas traumës F-43.1 (ICD10). Dënimi me 1(një) vit burg i të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është i kundërligjshëm, jo logjik me të cilin të akuzuarin i është shkelur për shërim në liri. Masën e shërimit psikiatrik në liri ekspertët mjekësor e kanë rekomanduar, ndërsa prokurori i shtetit e ka akceptuar me propozimin e tij për ndryshimin e aktakuzës. Masa e shërimit psikiatrik në liri përjashton sanksionin penal dënimit me burg, sepse janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Gjatë mbajtjes së dënimit me burg i akuzuarit privohet nga mundësia e zbatimit të masës së shërimit psikiatrik në liri. Në këtë mënyrë dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me vetveten e tij, me logjiken dhe me arsyetimin e tij. Propozon që gjykata me rastin e marrjes së vendimit ta ketë parasysh këtë fakt vendimtar, për të marr një gjykim të drejtë dhe të ligjshëm, ndonëse me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë e ka marrë parasysh gjendjen shëndetësore mendore të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës, ajo, megjithatë, nuk e ka marrë parasysh se aftësia e tij mendore për të gjykuar dhe vepruar drejtë ka qenë e zvogëluar esencialisht, gjë kjo e cila paraqet shkelje esenciale të dispozitave 69 dhe 70 të KPRK-së. I akuzuari është i varfër, i sëmur, jeton vetëm dhe s’ka askënd. Propozon që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovoj si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të mbrojturit të tij N.S të lirohet nga akuza ose ta anulon aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen t’ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Mbrojtësit të dëmtuarit R.B, av. N.R e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, ku pretendon se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit duke pasur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse nuk e ka caktuar drejtë dënimin ndaj tij dhe se nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore me ç ‘rast përkundër rastit shumë serioz dhe përkundër pasojave të rënda por si do që të jetë ndaj të akuzuarit është shqiptuar dënim shumë i butë duke mos marrë parasysh dispozitat ligjore si dhe Udhëzuesin për Politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës si dhe praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë. Në vazhdim ka potencuar se edhe pas dëgjimit të ekspertëve në shqyrtimin gjyqësorë asnjëri nga ata nuk ka ditur që të sqaroj se ku ka ndodhur aksidenti në vendbanim apo jashtë vendbanimi ngase aksidenti ka ndodh në dalje të fshatit .... drejtimi fshati ..... por askush nuk ka mundur nga ekspertët që ta specifikojë se a ka ndodhur

brenda vendbanimit apo jashtë kur kemi për bazë që kjo është mjaftë e rëndësishme edhe për përcaktimin e shpejtësisë së lëvizjes. Në rastin konkret ekspertiza e parë që është bërë, ajo e angazhuar nga ana e prokurorisë ka përcaktuar se shpejtësia e lëvizje në vendin ku ka ndodhur aksidenti ka qenë 40km/h dhe ajo është përcaktuar në bazë të shenjës së vendosur në fillim të fshatit nga ana e fshatit .... aty ku shenja e shpejtësisë ishte e vendosur në tabelën e lajmërimit për hyrje të fshatit .... dhe se aty nëse shpejtësia e lëvizjes është më e madhe se 40km/h me këtë rast ndryshojnë të gjitha parametrat e sidomos për palën e dëmtuar të cilën e përfaqëson. Me rastin e paqartë se aksidenti a ka ndodhur në fshatin .... apo jo me çka do të dihej edhe përcaktimi i kufizimit të shpejtësisë së lëvizjes në atë vend. Në anën tjetër ekspertiza e përpiluar nga grupi i ekspertëve ka përcaktuar se shkaktar të aksidentit janë katër automjetet që kanë qenë të përfshira në këtë aksident por Prokuroria ka vlerësuar se është e panevojshme të bëhet zgjerimi i aktakuzës edhe për dy ngasësit e automjeteve C dhe D. Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari N.S ka paraqit disa herë ankesa se është i sëmur, por i njëjti është parë duke e drejtuar traktorin edhe pas këtij aksidenti e që besohet në formën siç e kishte drejtuar edhe me rastin konkret pa patentë shofer dhe pa drita dhe pa shenja sinjalizuese. Tutje , konsideron se Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë nuk ka caktuar drejtë gjykimin dhe aktgjykimin ndaj N.S, duke marrë për bazë që të gjitha ekspertizat e kanë gjetur shkaktar të aksidentit të akuzuarin N.S meqenëse i njëjti kishte dalur me traktor në orët e vona të natës pa drita në anën e pasme si dhe pa asnjë sinjalizues , po ashtu pa patentë shofer e që tani i ndjeri A.B kishte qenë duke drejtuar automjetin Golf 2 në të njëjtën rrugë prapa traktorit të cilin e ka drejtuar N.S dhe në pamundësi që ta vërejë të njëjtin është ndeshur në të , i cili mbrapa në rimorikio e kishte barrën e ngarkuar me dru e po ashtu edhe barra nuk kishte qenë fare e shënjuar me shenjë përkatëse. I propozon Gjykatës e Apelit të Kosovës që të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim shumë më të lartë dhe atë dënim ta shqiptoj me dënim me burgim pasi që me dënim të tillë nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit .

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara me ankesë, si dhe as shkelje tjera të procedurës, të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjyqimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 2 të KPPK-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 369 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të pa provuara. Ajo ka dhënë arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjes juridiko penale, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të përgjegjësisë penale të akuzuarit. Në arsyetimin e aktgjyqimit përkitazi me ngjarjen e kryerjes së veprave penale në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridike penale, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë edhe mbrojtjen e të akuzuarit, kështu që përfundimet e gjykatës së shkallës së parë sa i takon mbrojtjes së tij, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë të drejta dhe të bazuara në ligj. Sa i përket pretendimi të mbrojtjes se Gjykata e shkallës së parë e ka tejkalluar aktakuzën pasi që në seancën e mbajtur

me 04.10.2022 prokurori i shtetit ka ndryshuar aktakuzën ashtu që ka kërkuar që të akuzuarit t'i shqiptohet masa trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, kolegji vlerëson se pretendimi i mbrojtjes nuk është i bazuara ngase në rastin konkret është vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 512 të KPPRK-së e cila dispozitë parasheh se nëse provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dëshmojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale në gjendje të paaftësisë mendore, prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor e ndryshon aktakuzën dhe paraqet propozim që gjykata të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqyrtimin e masës së tillë. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se gjykata pa pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ka marr aktvendim në procesverbal të seancës së mbajtur 18.07.2023, faqe 2, me të cilën e ka refuzuar propozimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij që të thirren dhe të dëgjohen dëshmitarët SH.S dhe N.Ç. Kolegji i Apelit fillimisht gjen se gjykata e shkallë së parë aktgjykimin e saj përkatësisht të akuzuarin nuk e ka shpallur fajtorë duke u mbështetur vetëm në deklaratat e këtyre dy dëshmitarëve dhe nuk i ka dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së këtyre dy dëshmitarëve duke qenë se aktgjykimi është i mbështetur në prova tjera materiale dhe personale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë e po ashtu nga shkresat e lëndës përkatësisht nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësorë të datës 18.07.2023 rezulton se sigurimi i prezencës së dëshmitarëve të lartpërmendur përkatësisht ardhja e tyre në gjykatë ka qenë e pa mundur edhe për kundër faktit se gjykata ka lëshuar urdhëresë për sjelljen e tyre në gjykatë, e në këtë rrethana kolegji konsideron se leximi i deklaratave të dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësorë si dhe refuzimi i propozimit të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij që këta dëshmitarë të sillen në gjykatë dhe të dëgjohen nuk e bëjnë aktgjykimin e kundërligjshëm dhe nuk është bazë ligjore e atij karakteri që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet.

Lidhur me pretendimet ankimore rreth gjendjes faktike Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore lidhur me gjendjen faktike nuk qëndrojnë, sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejtë pretendohet në ankesë. Se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe gjykuar, me pa mëdyshje nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar nga provat si ato personale dhe ato materiale si, Raporti i autopsisë i ekspertit mjekoligjor Dr.F.B i datës 14.01.2021 për të ndjerin A.B; Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ing.B.S e datës 18.01.2021; Superekspertiza e komunikacionit rrugor e punuar nga grupi i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të UP-së me nr.prot.057 e datës 31.03.2023; Ekspertiza mjeko ligjore e ekspertit Dr.F.D e datës 18.12.2020 dhe ekspertiza e dytë e datës 30.04.2021; deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit R.B dëshmia e dëshmitarit A.S, deklaratat e dëshmitarëve SH.S dhe N.Ç të dhëna në polici me datën 09 dhe 10.12.2020; Raportet mjekësore të SHSKUK-së për të lënduarit; Raporti për aksidentin e trafikut dhe skica e aksidentit, Fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes; Raporti për gjendjen e shëndetit mendor për të akuzuarin: N.S, me nr.362/2 i datës 29.07.2022; Ekspertiza e komunikacionit rrugor e punuar nga eksperti Y.K e datës 08.07.2021; fotografitë e dorëzuara si provë nga mbrojtësi i të akuzuarit; Raporti mjekësor i datës 11.05.2023, nga dëshmia e ekspertit të komunikacionit Dr.sc.M.B, nga dëshmia e ekspertit të komunikacionit Prof.Ass.Dr.R.D, si dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit, kështu që nga të lartcekurat ky kolegji vlerëson se drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë se duhet falë besimin këtyre provave, ngase të njëjtat ishin në harmoni me njëra tjetrën nga të cilat përtej çdo dyshimi



vërtetohet se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet si në përshkrimin faktik të veprës penale të përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit, për çka gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e saj e të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe ky kolegji, dhe nuk e sheh të arsyeshme të japë edhe njëherë vlerësimin për këtë. Pra nga të gjitha provat e administruara dhe drejtë të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë me të drejtë gjykata e shkallës së parë gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Kosovës, për çka me të drejtë e shpalli penalisht përgjegjës dhe fajtor. Një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoj edhe Kolegji Penal i kësaj gjykate.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë drejtë është aplikuar edhe ligji penale kur gjykata të akuzuarit i ka shpallur fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues dhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin i të aktgjykimit të ankimuar, ngase në veprimet e të akuzuarit konsumohen të gjitha elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë, në rastin konkret nuk ka rrethana të cilat përjashtojnë kundërligjshmërinë e apo përgjegjësinë penale të akuzuarit. Në rastin konkret është aplikuar ligji penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, drejtë janë aplikuar dispozitat për caktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit dhe se drejtë i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Sa i përket pretendimeve Mbrojtësi i të akuzuarit N.S, av, H.P dhe të përfaqësuesit të dëmtuarit R.B, av. N.R lidhur me vendimin mbi dënimin Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore, nuk janë të bazuara. Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori për bazë gjendjen shëndetësore-mendore të të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, kontributin e tani më të ndjerit në aksident, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin mori për bazë intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është jeta dhe shëndeti trupor i njeriut e që si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga lëshimet e të akuzuarit ka rezultuar me një person të vdekur , si dhe lëndime trupore të rënda dhe të lehta të tjerët.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e ankimore, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptoj një dënim tjetër. Të gjitha këto rrethana, sidomos faktin se nga superekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit është konstatuar dhe vërtetuar se i akuzuari nuk ka qenë kontribuesi i vetëm në aksident, e në këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me

intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.1279/23, më datë 27.02.2024**

**Procesmbajtësja,**  
Gentijana Manaj-Gashi

---

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

---

**Kryetar i kolegjit,**  
Mehmet Ndrecaj

---

Abdullah Ahmeti

---